



NEW HORIZON
Civil Society Organization

KOHA
Journal



ADMINISTRATA PUBLIKE E ORIENTUAR DREJT QYTETARËVE

Titulli i publikimit:

ADMINISTRATA PUBLIKE E ORIENTUAR DREJT QYTETARËVE

Botues:

OJQ “Horizonti i Ri”


Ulqin

Lagja Kodra pn, Ulqin

Tel: +382 68 300 603

E-mail: horizon@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

 [newhorizonngo](https://www.facebook.com/newhorizonngo)

Media partnere:

KOHA
Javore

Përgjegjës për botimin:

Nazif Veliqi

Ali Salaj

Ekipi realizues:

Hazreta Cuca

Almedina Doda

Nazif Veliqi

Faqosja dhe dizajni:

Alma Sulejmanoviq

Shtypi:

Promotive - Podgoricë

Ulqin, 2022

Ky publikim u realizua në kuadër të projektit “Parandalimi i Korrupsionit dhe Promovimi i Pjesëmarrjes Qytetare” i mbështetur nga Departamenti i Shtetit të SHBA, Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL). Përmbajtja e këtij teksti është përgjegjësi vetëm e autorit dhe nuk përfaqëson medoemos pikëpamjet apo qëndrimin e donatorit.

Administrata publike duhet të jetë në shërbim të qytetarëve dhe urë lidhëse midis politikës zyrtare dhe publikut. Ajo është vija e parë e frontit ku vendimet e marra nga politika duhet të vihen në jetë. Funksionimi i shtetit dhe efikasiteti i politikave nga ana e qeverisë varen nga një administratë profesionale, e përgjegjshme dhe e pavarur nga ndikimet e jashtme.

ÇFARË ËSHTË REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE?

Reforma e administratës publike është reforma e vetë shtetit, pra e administratës shtetërore dhe asaj lokale. Kompleksiteti i këtij procesi reflektohet në faktin se të gjitha aktivitetet e kryera duhet të kenë përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët dhe sektorin e biznesit. Për këto arsye, administrata publike, e cila ka qenë gjithmonë një çështje e brendshme e vendeve anëtare të BE-së, është kthyer në një nga tre shtyllat kryesore në procesin e zgjerimit të BE-së. Kjo bëhet me qëllim që të sigurohet zbatimi i plotë i legjislacionit të BE-së, por edhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve.

Reforma e administratës publike është një nga segmentet kyçe në kuadër të proceseve të përgjithshme reformuese në Mal të Zi. Me qëllim të vazhimit të pandërprerë të reformës së administratës publike, Qeveria ka përgatitur Strategjinë e Reformës së Administratës Publike 2022-2026.

Me administratë publike në këtë dokument strategjik nënkuptohet:

në nivel qendror - organet e administratës shtetërore, personat juridikë që ushtrojnë autoritet publik dhe institucionet publike,

në nivel vendor - organet dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore

VIZIONI DHE VLERAT E REFORMËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Vizioni i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2022-2026 është: *një administratë publike profesionale që ofron shërbime cilësore për qytetarët dhe ka kapacitete të përshtatshme për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.*

Vlerat mbi të cilat bazohen vizioni dhe qëllimet e Strategjisë janë:



Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022-2026 promovon qasje më të madhe në informacion për t'ua lehtësuar jetën qytetarëve, veçanërisht përmes krijimit të shërbimeve të digjitalizuara dhe regjistrave të ndërveprueshëm. Gjithashtu, planifikimi dhe punësimi efikas i nëpunësve civilë në përputhje me nevojat reale të organeve publike, mundësimi i shkëmbimit të tyre si dhe përdorimi i teknologjisë përmes punës në distancë, do të jenë në fokus të periudhës së ardhshme katërvjeçare të zbatimit të Strategjisë. Promovimi i diversitetit dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në punën e administratës publike, afirmimi i nevojave të shprehura të qytetarëve përmes pjesëmarrjes në debate publike, por edhe ndikimi i drejtpërdrejtë në punën e organeve, synon zhvillimin e politikave publike të bazuara në nevojat e identifikuara të qytetarëve.

ÇFARË BËJMË

Së bashku ndërtojmë administratë publike të qytetarëve -transparente, të aksesueshme, efikase, profesionale.

SI PUNOJMË

Përshtatja dhe ndryshimi i mënyrës se si hartohen politikat dhe shërbimet publike, në mënyrë që ato të jenë plotësisht orientuara te qytetarët.

Ndryshimi i praktikës dhe kulturës organizative - siguron modernizimin e administratës publike.

Transformimi i shërbimeve për t'i bërë ato më të shpejta, më të thjeshta, më të aksesueshme dhe më funksionale për qytetarët dhe bizneset.

PËR KË PUNOJMË

Publikun e gjerë - qytetarët

Mediat

OIQ-të

Bizneset dhe shoqatat e tjera profesionale

Sindikatat

Komunitetet akademike

Publikun ndërkombëtar

Punonjësit në qeverisjen qëndrore dhe lokale

QËLLIMET KYÇE TË REFORMËS

Qëllimi kryesor i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2022-2026 është *ndërtimi i një administrate publike të përgjegjshme, efikase, transparente, të fokusuar në nevojat e qytetarëve dhe të biznesit.*

Ky dokument strategjik përcakton 5 qëllime strategjike:



ORGANIZIMI DHE PUNA E ADMINISTRATËS PUBLIKE NË FUNKSION TË NEVOJAVE TË QYTETARËVE



QYTETARËT DHE BIZNESET SHFRYTËZOJNË SHËRBIME CILËSORE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE



ADMINISTRATË PUBLIKE PROFESIONALE



ADMINISTRATË E HAPUR DHE TRANSPARENTE



PLANIFIKIM I POLITIKAVE ME QYTETARËT DHE PËR QYTETARËT

ADMINISTRATA VENDORE E ORIENTUAR DREJT QYTETARËVE


Puna për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën e administratës vendore është një kontribut i fuqishëm për cilësinë e demokracisë.

QEVERISJA E MIRË VENDORE

redukon korrupsionin në minimum, merr parasysh pikëpamjet e grupeve më të ndjeshme të shoqërisë dhe siguron që zëri i qytetarëve të dëgjohej gjatë procesit të vendimmarrjes.

u përgjigjet nevojave të tashme dhe të ardhshme të shoqërisë

Vetëqeverisja vendore është një proces kalimi deri tek qeveria (qendrore) në tërësi, andaj rezultatet e forcimit të llogaridhënies dhe transparencës në nivelin lokal, i kontribuojnë besueshmërisë së administratës publike në tërësi.



Përfaqësimi i interesave të qytetarëve është parimi më i rëndësishëm

Në një shoqëri demokratike, përfaqësimi i interesave të qytetarëve është parimi më i rëndësishëm.

Qytetarët në mënyrë periodike u japin mandatin përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Ata iu delegojnë disa nga kompetencat e tyre kandidatëve të cilëve u besojnë. Ky është themeli i demokracisë.

Në nivele të ndryshme të skenës politike, ky akt paraqet pjesën thelbësore të marrëdhënieve ndërmjet votuesve dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Ai është një nga tre elementët bazë në trekëndëshin e legjitimitetit. Elementi i parë i legjitimitetit të përfaqësuesve të zgjedhur - mirëbesimi është përgjegjësia më e rëndësishme e kuvendit të zgjedhur (të gjithë anëtarët e parlamentit lokal).

Elementi i dytë është marrëdhënia midis kuvendit dhe ekzekutivit (kryetarit të komunës dhe administratës vendore). Kjo marrëdhënie bazohet te siguria (ligjore), e cila mund të shihet si legjitimitet institucional, pra si përgjegjësi e organeve të zgjedhura në mënyrë legjitime për ushtrimin e pushtetit.

Elementi i tretë është kënaqësia dhe ka të bëjë me shërbimet e mira publike.

Përmbushja e nevojave publike është përgjegjësia themelore e vetëqeverisjes lokale (organit përfaqësues dhe ekzekutivit) dhe e çdo nëpunësi publik, individualisht.

Llogaridhënia publike siguron që zyrtarët të përgjigjen në mënyrë të hapur për vendimet që ata marrin në emër të publikut.

Mirëbesimi, siguria dhe kënaqësia janë elementët që përshkojnë dhe e ruajnë sistemin si një çati. Transparenca dhe llogaridhënia janë shtylla tepër të rëndësishme. Ato janë të rëndësishme për kulturën organizative, për të penguar administratën publike dhe lidhshimin politik nga korrupsioni dhe mashtrimet.

PËRMASAT E QYTETARISË

Qytetarët dhe administrata vendore janë të lidhur në përmasa të ndryshme. Qytetari është një klient që parashtron kërkesa të larta në drejtim të ofrimit të shërbimeve. Qytetari është po ashtu votues që me votën e tij investon në marrëdhënien e mirëbesimit me përfaqësuesit e zgjedhur. Për më tepër, qytetari merr pjesë edhe në hartimin dhe miratimin e politikave publike. Pushteti vendor fton rregullisht qytetarët që së bashku të hartojnë politika në mënyrë pjesëmarrëse. Së fundi, qytetari është pjesë e komunitetit qytetar në të cilin autoritetet vendore ushtrojnë pushtetin, kurse qytetari është subjekt aktiv.



QYTETARI

- Klient
- Votues
- Pjesëmarrës në hartimin e politikave
- Subjekt



QEVERISJA LOKALE

- Ofrues shërbimesh
- Përfaqësues i zgjedhur
- Politikbërës
- Organ mbikëqyrës

Këto përmasa janë veçanërisht specifike në nivelin vendor, aty ku qeveria dhe administrata publike vendore janë nivelet më të afërta të pushtetit. Në këtë mënyrë, marrëdhënia ndërmjet qytetarit dhe organit kompetent (lokal) mund të shihet si një burim pushteti dhe autoriteti që është i rëndësishëm për sistemin demokratik në përgjithësi.

QEVERISJA VENDORE DUHET TË JETË E DUKSHME DHE E NDJESHME

Afërsia e qeverisjes vendore me qytetarin përcaktohet nga dy aspekte: **dukshmëria** dhe ndjeshmëria. Këto aspekte janë veçanërisht të rëndësishme për sa i përket llogaridhënies dhe transparencës.

Dukshmëria e bën qeverisjen më të hapur dhe mund të shihet si një mundësi: atë që shihni, merrni.



Kur pushteti vendor iu përmbahet këtyre dy parimeve, rezultatet janë të matshme. Qytetarët dhe bizneset mund t'i përfitojnë ato drejtpërdrejt: nga një leje ndërtimi te një lagje e pastër.

Afërsia e pushtetit me qytetarin krijon **ndjeshmëri**, por mund të paraqesë edhe kërcënim. Çdo hap i ndërmarrë nga pushteti vendor mund të konsiderohet si një gjest publik i personave ose dikasterëve te pushtetit. Kjo do të thotë që njerëzit mund të presin një shpjegim për çdo hap të ndërmarrë nga zyrtarët publikë ose përfaqësuesit politikë, edhe kur nuk ka asnjë arsye (formale) për këtë. Kjo ndonjëherë mund ta ndërlikojë veprimin e pushtetit, veçanërisht në kohë presioni politik. Afërsia në kuptimin e fqinjësisë e ndërlikon më tej atë. Arsyet personale, lidhjet e vjetra, detyrimet familjare mund të çojnë në pritjen e një trajtimi të veçantë që nuk mund të sigurohet në përputhje me rregullat e vendosura me ligj. Prandaj, afërsia në nivelin lokal mund të jetë përparësi dhe mangësi në marrëdhëniet midis qytetarëve dhe administratës publike.

LEGJITIMITETI I PUSHTETIT KËRKON PUNË TË PALODHUR

Pushteti vendor duhet të punojë në mënyrë aktive për të shmangur rreziqet e shumta që mund të rrezikojnë legjitimitetin e sistemit demokratik. Marrëdhëniet intensive dhe komplekse me qytetarët kërkojnë fuqizim të vazhdueshëm të stafit, rritje të njohurive dhe kompetencave të nëpunësve publikë si dhe të organeve politike. Çdo gabim i vogël në aspektin e integritetit të një zyrtari publik do të thotë dëmtim i tërësisë.

Prandaj, është e rëndësishme të miratohen aktet përkatëse, siç janë: rregulloret e punës, vendimet dhe rregulloret, të cilat përcaktojnë procedurat, mënyrën e punës dhe vendimmarrjes, menaxhimin e rregullt dhe transparent si dhe kryerjen e punëve publike nga këshilltarët, drejtuesit dhe zyrtarët vendorë. Thënë shkurt, ky është një investim në besimin e ndërsjellët.

“Pra, jini të hapur për sa i përket zbatimit të rregullores, sepse kjo është një lloj mbrojtjeje publike”. Kjo është një deklaratë mbi drejtësinë dhe përkushtimin ndaj integritetit. Këto akte potencojnë nevojën për standarde morale të administratës publike, por nga ana tjetër, ata mund të jenë një shenjë besueshmërie për sektorin privat dhe një nxitje pozitive për taksapaguesit në kuptimin **“Paratë tuaja i shpenzuar për të mirat publike, prandaj kjo qeverisje është e besueshme”**.

Partnerë në kredibilitet dhe mirëbesim

Politikanët, nëpunësit civilë dhe aktorë të tjerë, si bizneset, OJQ-të dhe qytetarët si individë, janë partnerë të pushtetit vendor që meriton besimin. Kjo kërkon trajnim të vazhdueshëm praktik, ndërgjegjësim për rëndësinë e sigurisë, kredibilitetit dhe mirëbesimit.

Kjo nënkupton zhvillimin e përhershëm të transparencës në marrëdhëniet midis qytetarëve dhe administratës publike (lokale). Integriteti dhe pjesëmarrja janë të nevojshme për njëri-tjetrin, gjë që në radhë të parë do të thotë se pushteti vendor dhe nëpunësit publikë vendorë duhet të jenë të hapur ndaj nevojave për informim të qytetarëve, bizneseve, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit etj. Kjo do të thotë se ata duhet të jenë të informuar mirë për vendimmarrjen në përgjithësi, por edhe për procedurat dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve specifike (p.sh.: marrja e lejes së ndërtimit, dhënia e licencës për shitjen e mallrave në treg, etj.)

*Pushteti vendor duhet të jetë
i hapur ndaj ideve të qytetarëve*

Së dyti, pushteti vendor duhet të jetë **i hapur ndaj ideve të qytetarëve**. Sa herë që kuvendi i komunës merr vendim për çështje të rëndësishme dhe komplekse, siç është buxheti vjetor, duhet të shqyrtojë nëse dhe si janë konsultuar qytetarët. Pushteti vendor duhet të përpiqet të ndërtojë një platformë të drejtë dhe të fuqishme për vendime të vështira dhe të përdorë me mençuri fuqinë e mendimit të komunitetit.

Pushteti vendor **duhet të jetë gjithmonë i gatshëm të përfshijë qytetarët** për një sërë arsyesh. Kjo nuk është gjithmonë e lehtë dhe kërkon **një ekuilibër midis distancës dhe detyrimit të pushtetit**. Kjo është gjithashtu një mënyrë për t'u njohur me mundësitë që ofron ndërveprimi aktiv me popullsinë, edhe në aspektin e ruajtjes së besimit dhe sigurisë si shtytës i sistemit demokratik.

Së fundi, duhet kuptuar se **integriteti përbën një rrezik** kur nuk jeni njohur me disa arsye **pro dhe kundër**. Transparenca në nivel individual e një zyrtari publik dhe veçanërisht e një politikani është thelbësore sepse ky fakt tregon se ekzistojnë rregulla të qarta në ushtrimin e funksionit publik. Prandaj është e rëndësishme që të zhvillohen dhe zbatohen procedura transparente në drejtimin e punëve publike, në vendosjen e marrëdhënieve duke ndarë sa më shumë çështjen e përgjegjësisë individuale nga ajo kolektive. Një qeverisje e drejtë bazohet në parimet që nënkuptojnë se zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar mund t'u besohet si aktorë që punojnë dhe kryejnë funksione në interesin publik dhe ofrimin e të mirave publike për të gjithë qytetarët.


Përgjegjshmëria, në mënyra të ndryshme, është thelbi i punës së administratës publike. Ajo krijon bazën e një shoqërie të hapur dhe demokratike me një ekuilibër midis qytetarëve dhe administratës publike. Duke qenë përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhurit – politikanët duhet të jenë të vetëdijshëm për pozicionin e privilegjuar në zemër të administratës publike dhe se ruajtja e besimit duhet të jetë qëllimi i tyre parësor. Kjo krijon bazën për administratë efektive dhe ofrim efikas të shërbimeve në të gjitha nivelet e shoqërisë.

KONCEPTET THEMELORE TË ADMINISTRATËS

Paraqitja dhe zhvillimi i administratës është i lidhur me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, kulturor dhe shoqëror. Administrata ka rol të dyfishtë historik në shoqëri, ku njëkohësisht është instrument i pushtetit dhe bartës i punëve të dobishme me të cilat përmbushen nevojat e qytetarëve.

E drejta për informim

Një element i rëndësishëm i transparencës është e drejta për informim që ka çdo person i interesuar dhe që mund ta ushtrojë me anë të një kërkesë për t'u vënë në dijeni lidhur me procedura të caktuara të prokurimit publik, koncesionit apo ankandit. Në mbështetje të këtij parimi të rëndësishëm, janë rregulluar edhe të gjitha kërkesat e tjera të ligjeve të prokurimit e kontratave publike, ndërsa parashikohet që i gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet të bëhen ose dokumentohen me shkrim. Zbatimi i këtij parimi është një mënyrë shumë e efektshme që u lejon personave privatë të kërkojnë, verifikojnë dhe denoncojnë rastet e konfliktit të interesave. Gjithashtu, një element përbërës i transparencës është mbikëqyrja publike që i referohet përfshirjes së qytetarëve në procesin e zhvillimit të procedurave të prokurimit. Mbikëqyrja përfshin edhe një rol aktiv të qytetarëve duke qenë se ata janë përfitues të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të procesit të prokurimit, jo vetëm për faktin se burimet e financimit të objekteve të prokuruar janë kontributi i tyre përmes taksave të paguara, por edhe sepse ata në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë përfitues të mallrave, shërbimeve dhe punimeve që kryhen përmes kontratave publike.



Etika në administratën publike

Etika në administratën publike është një aspekt me rëndësi madhore dhe me vlera sa morale aq edhe ligjore. Ajo është një kategori juridike, pra një sërë aktesh ligjore e nënligjore që përcaktojnë standarde sjelljeje të punonjësve të administratës publike. Respektimi i saj është i detyrueshëm. Megjithatë, respektimi i etikës varet shumë nga ekzistenca e normave sa më të qarta, njohja e mirë e tyre si dhe masat që ato parashikojnë për rastet e moszbatimit të ligjit. Institucionet duhet të punojnë shumë për miratim rregullash të brendshme si dhe trajnim të zyrëtarve për kuptimin sa më të mirë të rregullave mbi etikën.

Qytetarët kur shkojnë në një administratë publike presin që punonjësit e saj u shërbejnë atyre me ligjshmëri, korrektësi, paanësi, transparencë, integritet, lehtësi, pa kosto ose të paktën jo me një kosto disproporcionale, etj. Pra, ata presin që ndërkohë që marrin shërbimin nga administrata e tyre publike, ta marrin atë të shërbyer edhe në mënyrën e duhur. Etika dhe llogaridhënia publike janë karakteristikat kryesore të një qeverisje efektive vendore. Ato i referohen kulturës, proceseve dhe rregullave, të cilat garantojnë që zyrtarët publikë të veprojnë në shërbim të interesit të komunitetit dhe jo interesave personale. Këto janë veçoritë thelbësore të qeverisjes së mirë.





Nocioni i pjesëmarrjes së publikut

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes është vitale për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Pjesëmarrja në vendimmarrje krijon një urë komunikimi në mes të autoriteteve publike në një anë dhe qytetarëve në anën tjetër, në çështjet që përfshijnë interesin e përgjithshëm dhe publik. Përmes pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes, qytetarëve iu sigurohet e drejta e pjesëmarrjes, të kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve dhe veprimtarive të organeve qendrore dhe vendore në çështjet që ndikojnë në jetën e tyre në kuptimin publik. Një ndërveprim i tillë mundëson shkëmbimin e ideve dhe komenteve që janë relevante për autoritetet publike në procesin e hartimit të vendimeve, dokumenteve, programeve dhe planeve strategjike lokale.

Nocioni i pjesëmarrjes së publikut nuk nënkupton thjeshtë ofrim të garancive juridike dhe institucionale për pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes. Kuptimi i saj i plotë dhe efekti i saj praktik kushtëzohet nga niveli i reflektimit dhe përfshirjes së zgjidhjeve të ofruara nga publiku gjatë procesit të vendimmarrjes. Sa më e lartë të jetë shkalla e konsultimit publik në procesin e vendimmarrjes, aq më domethënës dhe kuptimplotë do jetë parimi i pjesëmarrjes të publikut në proceset e vendimmarrjes.

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes ka mbështetje juridike dhe kushtetuese. E drejta në shprehje dhe qasje në informacion i detyron autoritetet të lehtësojnë pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit të vendimmarrjes. Pjesëmarrja e qytetarëve krijon përgjegjësinë dhe transparencën e autoriteteve publike në procesin e vendimmarrjes dhe fuqizon mbështetjen publike për vendimet që merren.



NEW HORIZON
Civil Society Organization



+382 68 300 603



www.ngo-horizonti.org



New Horizon NGO



ngohorizonti@t-com.me



[newhorizonngo](https://www.facebook.com/newhorizonngo)



[newhorizon_ngo](https://www.instagram.com/newhorizon_ngo)



This project is supported by

U.S. Department of State Bureau of International Narcotics
and Law Enforcement Affairs (INL) Criminal Justice Civil Society Program